

UDHËZIM
Nr.2, datë 18.3.2004

**PËR PROCEDURAT E LËVIZJES SË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE,
TË LUAJTSHME, ME VLERA TË VEÇANTA, KOMBËTARE DHE UNIKALE,
PËR RUAJTJEN, RESTAURIMIN, STUDIMIN DHE EKSPOZIMIN JASHTË TERRITORIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Lëvizja e objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, të përcaktuara nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për ruajtjen, restaurimin, studimin apo ekspozimin e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të bëhet sipas procedurave të mëposhtme:

1. Institucioni ose personi fizik ose juridik, shtetëror ose privat, i paraqet kërkesën me shkrim Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Relacionin shpjegues.
- b) Arsyen e lëvizjes së këtyre objekteve.
- c) Vendin ku do të çohen objektet, për arsye ekspozimi, restaurimi apo studimi.
- ç) Kohëzgjatjen e qëndrimit të objekteve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe datat e nisjes e të rikthimit të objekteve në institucionin ku ruhen, ekspozohen dhe administrohen.
- d) Listën e objekteve, të miratuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, të shoqëruar me pasaportën përkatëse për secilin objekt, të plotësuar nga kjo qendër.
- dh) Vendimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, kur objektet dalin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për qëllime restaurimi.

e) Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet institucionit apo personit juridik a fizik, privat ose shtetëror që i administron objektet dhe institucionit pritës.

ë) Policën origjinale ose të noterizuar, të primit të sigurimit të objekteve për të gjithë periudhën që ato do të jenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe për periudhën e transportit. Kjo policë duhet të jetë e klauzolës A, tipi "*all risks*", përfshi edhe transportin.

f) Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet institucionit që administron objektet dhe institucionit, personit fizik ose juridik, shtetëror ose privat, që do të bëjë sigurimin fizik të objekteve gjatë lëvizjes së tyre, brenda dhe jashtë vendit.

3. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pas plotësimit të dokumentacionit të mësipërm, i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për ruajtjen, restaurimin, studimin apo ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano